



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	15.07.2026	27.07.2026	2026/0486

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.07.2026, OE **“Rexhep Birinxhiku”- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2026/0486**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE **“Office 1 Kosova” SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me leter per kopje” LOT 2** me nr. të prokurimit: **"201/26300-26-2073-1-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit .

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **Lot 2 – 690,000.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

PRETENDIMI NJË

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

PRETENDIMI DY

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

PRETENDIMI TRE

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

PRETENDIMI KATËR

Zbatim i gabuar i Nenit 40.10 të Rregullores Nr.001/2022

PRETENDIMI PESË

Neni 40.9 i Rregullores Nr. 001/2022 dhe; Interpretimi ligjor nga KRPP, lidhur me gabimin aritmetik: 9. 22.11.2022 Gabimi aritmetikor ka ndodhë në ofertën financiare e jo në rubrikën (tabelën) për poentim të çmimeve. Cila vlerë mbizotëron, Vlera totale Financiare e ofertës për çmim njësi apo vlera totale e poentuar?

PRETENDIMI GJASHTË

Neni 59.4 i LPP-së.

PRETENDIMI SHTATË

Neni 40.7 i Rregullores

PRETENDIMI TETË

Neni 40.8 i Rregullores.

PRETENDIMI I, Shkelja e nenit 40.9 të Rregullores Nr. 001/2022, nenit 59 të LPP-së dhe zbatimi i gabuar i legjislacionit nga Autoriteti Kontraktues Autoriteti Kontraktues ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat që rregullojnë trajtimin e gabimeve aritmetike gjatë vlerësimit të ofertave. Nga vetë vendimi rezulton se Autoriteti ka konstatuar ekzistimin e një mospërputhjeje të numrave në ofertë. Megjithatë, në vend që të zbatojë procedurën e detyrueshme të korrigjimit të gabimeve aritmetike, ka kaluar menjëherë në eliminimin e operatorit ekonomik. Ky veprim bie ndesh me qëllimin e nenit 40.9 të Rregullores Nr. 001/2022 dhe nenit 59 të LPP-së, të cilat synojnë të shmangin eliminimin për gabime të korrigjueshme dhe të ruajnë konkurrencën efektive. Autoriteti Kontraktues nuk ka analizuar, natyrën juridike të gabimit, nëse gabimi është realisht aritmetik, nëse gabimi është i korrigjueshëm, tejkalohe kufiri ligjor prej 2%, ndikimin real të gabimit në renditjen e ofertave, nëse çmimet për njësi mbeteshin të pandryshuara, nëse ndryshonin specifikimet teknike, nëse ndryshonin detyrimet kontraktuale. Asnjë nga këto elemente nuk është analizuar në vendim. Në vend të kësaj, AK na ka eliminuar, duke anashkaluar zbatimin ligjor për korrigjimin e ofertës. Një interpretim i tillë nga autoriteti kontraktues të kundërligjshëm e bën nenin 40.9 praktikisht të pazbatueshëm dhe bie ndesh me qëllimin për korrigjimin e çmimit të ofertës. Sqarim: Nëse çdo mospërputhje numerike do të çonte automatikisht në eliminimin e ofertave, atëherë dispozita që lejon korrigjimin deri në kufirin prej 2% do të mbetej pa efekt juridik. Ky interpretim është i papranueshëm dhe autoriteti kontraktues ka bërë tejkalim të përgjegjësive. Poashtu për autoritetin, nëse ne do të ishim të parët dhe të kishim dal në vendin e dytë a do të ishim eliminuar ?.

PRETENDIMI II Autoriteti juaj kontraktues është i obliguar të trajtojë të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Në rastin konkret, elimini i ofertët tonë për një gabim aritmetik që sipas legjislacionit është i korrigjueshëm, paraqet trajtim jo

proporcional dhe cenon parimin e konkurrencës dhe barabarsisë në mes të operatorëve ekonomik. Ju si autoritet kontraktues, nuk keni dëshmuar se gabimi ka krijuar avantazh konkurrues apo ka dëmtuar konkurrencën në mes të operatorëve tjerë ekonomikë. Andaj kishte me qenë e arsyshme të jepni arsye se qfarë ndikimi dhe efekti ka arsyeja e eliminimit tonë në kuadër të zhvillimit të procedurës. Ne si operator ekonomik ankues vlerësojmë se autoriteti kontraktues ka bërë interpretim të gabuar dhe zbatim selektiv të interpretimit zyrtar të KRPP-së dhe konsiderojmë se me këtë autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të parimit të ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe trajtimit të barabartë. Autoriteti Kontraktues, në arsyetimin e vendimit të kontestuar, pretendon se interpretimi zyrtar i KRPP-së lidhur me gabimet aritmetike nuk është i zbatueshëm në rastin konkret, me arsyetimin se procedura nuk ka qenë me "poentim të çmimeve". Ky përfundim është i pabazuar, logjikisht i paqëndrueshëm dhe përfaqëson një interpretim selektiv të legjislacionit. Autoriteti kontraktues nuk ka bërë asnjë analizë juridike për të shpjeguar pse dispozitat e nenit 59 të LPP-së dhe nenit 40.9 të Rregullores nuk do të ishin të zbatueshme vetëm për shkak të formatit të ofertës financiare. LPP, nuk bën një dallim të tillë dhe as interpretimi i KRPP-së, nuk përjashton rastet kur oferta financiare paraqitet përmes Listës së Çmimeve. Interpretimi i KRPP-së nuk është nxjerrë për një aktivitet të vetëm të prokurimit, por për të sqaruar mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore mbi gabimet aritmetike. Prandaj, ak duhet të zbatohet në çdo rast kur konstatohet një mospërputhje aritmetike gjatë vlerësimit të ofertave në rastet kur plotësohen kushtet si në rastin konkret. Ne si operator ekonomik vlerësojmë se Interpretim selektiv nga autoriteti kontraktues për interpretimin e KRPP, duke ka marrë vetëm atë pjesë të interpretimit të KRPP-së që i shkon për shtat qëndrimit të tij, ndërsa ka injoruar pjesën thelbësore të interpretimit, sipas së cilës: 1.Gabimet aritmetike deri në kufirin prej 2% duhet të korrigjohen; 2.Autoriteti Kontraktues duhet të njoftojë operatorin ekonomik për korrigjimin. Ky është një interpretim i pjesshëm dhe selektiv, i cili bie ndesh me parimin e ligjshmërisë. Andaj autoriteti kontraktues, nuk mund ta interpretoj interpretimin e KRPP-së, duke shkëputur vetëm disa pjesë të tij dhe ka anashkaluar pjesën thelbësore e cila ndërlidhet me objektin e ankesës. Sqarojmë se KRPP është organi kompetent për interpretimin administrativ të legjislacionit të prokurimit publik. Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë të kufizojë ose të ndryshojë pjesë të një interpretimi zyrtar përmes një vendimi. Një interpretim i KRPP-së sqaron se gabimet aritmetike deri në pragun ligjor trajtohen sipas procedurës së korrigjimit, AK, nuk mund të krijojë një kategori të re rastesh të përjashtuara nga kjo procedurë pa bazë ligjore.Në të kundërtën, kjo do të krijonte pasiguri juridike dhe do të lejonte që secili autoritet kontraktues të aplikonte rregulla të ndryshme për të njëjtën çështje të njëjtë.Poashtu ne si operator ekonomik sqarojmë se Vendimi i AK nuk përmban asnjë analizë të dispozitave të nenit 59 të LPP-së dhe nenit 40.9 të Rregullores. Nuk shpjegon pse gabimi nuk konsiderohet aritmetik, pse nuk zbatohet procedura e korrigjimit, dhe pse nuk aplikohet pragu prej 2%.

PRETENDIMI III Shkelja e Nenit 59 të LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Neni 59 i Ligjit për Prokurimin Publik obligon Autoritetin Kontraktues që gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave të veprojë në mënyrë objektive, të paanshme dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar standardin e kërkuar ligjor gjatë ekzaminimit të ofertës sonë. Nga dokumentacioni i procedurës rezulton se Autoriteti nuk ka bërë një analizë të plotë të ofertës, por është fokusuar ekskluzivisht në një mospërputhje të numrave (vlerave) duke e trajtuar atë si arsye për eliminim. Një qasje e tillë bie ndesh me vetë qëllimin e nenit 59 të LPP-së, i cili kërkon që ofertat të vlerësohen në tërësi dhe jo mbi baza formale që nuk ndikojnë në përmbajtjen substanciale të ofertës. Autoriteti kontraktues nuk ka

analizuar, nëse gabimi ka ndikuar në çmimin përfundimtar të ofertës, nëse gabimi ka ndryshuar renditjen e operatorëve ekonomikë, nëse gabimi ka ndikuar në përmbushjen e kërkesave teknike, nëse gabimi ka krijuar avantazh të padrejtë, nëse gabimi ka cenuar konkurrencën. Andaj ky veprim përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 59 të LPP-së. Autoriteti Kontraktues poashtu ka vepruar në kundërshtim me parimin e vlerësimit substancial të ofertave, parim i cili është njohur vazhdimisht në rastet dhe praktikatat e OSHP-së dhe KRPP-së. Qëllimi i procesit të vlerësimit nuk është eliminimi i operatorëve ekonomikë për çështje formale, por identifikimi i ofertës së përgjegjshme dhe ekonomikisht më të favorshme. Andaj vendimi për eliminim është rezultat i një vlerësimi joobjektiv dhe jo të profesional nga autoriteti kontraktues në raport me ofertën tonë.

PRETENDIMI IV Zbatim i gabuar i Nenit 40.10 të Rregullores Nr.001/2022 Autoritet kontraktues e ka trajtuar rastin si mospërputhje që çon automatikisht në refuzimin e ofertës. Megjithatë, nga vetë arsyetimi i AK-së dhe nga sqarimi i paraqitur nga ne si OE rezulton se kemi të bëjmë me një gabim aritmetik të paqëllimshëm. Për këtë, para aplikimit të vlerësimit për eliminim AK, ka qenë e obliguar të analizojë natyrën e gabimit dhe ndikimin e tij real në ofertë. Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka mbajtur qëndrimin se në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet për korrigjimin e gabimit dhe se eliminimi i ofertës është në përputhje me nenin 40.10 të Rregullores. Megjithatë, vendimi nuk përmban analizë konkrete se pse janë plotësuar elementet ligjore të kësaj dispozite dhe nuk sqaron marrëdhënien ndërmjet nenit 40.9 dhe nenit 40.10. Autoriteti Kontraktues e ka interpretuar nenin 40.10 në mënyrë të shkëputur nga dispozitat paraprake të Rregullores, duke anashkaluar faktin se neni 40.10 nuk mund të zbatohet në mënyrë pa u analizuar fillimisht nëse ekziston një gabim aritmetik i korrigjueshëm sipas nenit 40.9. Interpretimi i Rregullores kërkon që të gjitha dispozitat e saj të lexohen së bashku dhe në harmoni me njëra-tjetrën. Neni 40.10 nuk është normë specifike për eliminimin e ofertës, por pjesë e përgjithshme për trajtimin e gabimeve gjatë vlerësimit të ofertave.

PRETENDIMI VSHKELJA E NENIT 40.9 TË RREGULLORES NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK DHE ZBATIMI I GABUAR I NENIT 59.3 TË LPP-SË

Autoriteti kontraktues, me rastin e vlerësimit të ofertës tonë, ka vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 40.9 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik dhe nenin 59.3 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke eliminuar ofertën tonë për një mospërputhje, ndonëse korrigjimi i konstatuar nuk e kalon kufirin ligjor prej 2% të vlerës totale të ofertës.

Neni 40.9 i Rregullores përcakton në mënyrë specifike se Autoriteti Kontraktues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike të zbuluara gjatë ekzaminimit të tenderëve, për aq kohë sa korrigjimi nuk tejkalon dy për qind (2%) të vlerës totale të ofertës. Po ashtu, paragrafi 40.9(a) e përcakton si rregullë detyruese se kur shumat e korrigjuar është më pak se +/- 2%, Autoriteti Kontraktues duhet të bëjë korrigjimin dhe ta njoftojë Operatorin Ekonomik përmes formularit standard B49. Vetëm në rastet kur korrigjimi është më i madh se +/- 2%, paragrafi 40.9(b) e eliminon e operatorit ekonomik nga procedura e prokurimit. Në rastin konkret rezulton se vlera e ofertës tonë ka qenë 533,479.00 €, ndërsa pas korrigjimit të pretenduar aritmetik vlera rezulton 527,620.00 €.

Diferenca prej 5,859.00 € është vetëm 1.10% të vlerës totale të ofertës. Kjo do të thotë se korrigjimi i konstatuar është më pak se 2% të lejuar nga ligji dhe rregullorja. Për pasojë, autoriteti kontraktues nuk ka pasur bazë ligjore për eliminimin e ofertës tonë, por ka qenë të

obliguar të zbaton korrigjimin të paraparë nga legjisacioni përkatësishtë, neni 40.9(a) i Rregullores.

Për më shumë ka edhe interpretim nga KRPP-ja, interpretimi i dhënë nga KRPP lidhur me nenin 59.3 të LPP-së dhe nenin 40.9 të Rregullores sqaron se kur gjatë vlerësimit konstatohet një gabim aritmetik, Autoriteti Kontraktues është i obliguar ta korrigjojë atë deri në kufirin prej 2% dhe të njoftojë operatorin ekonomik, ndërsa eliminimi është masë që zbatohet vetëm kur tejkalohet ky prag ligjor. Ky interpretim konfirmon se legjislacioni i prokurimit publik nuk e trajton eliminimin si rregull, por si përjashtim që aktivizohet vetëm kur korrigjimi kalon kufirin e përcaktuar me 6 ligj. Veprimi i autoritetit kontraktues bie ndesh edhe me parimin e interpretimit të normave juridike. Në rastin konkret, autoritet kontraktues ka vendosur të zbaton eliminimin tonë, duke anashkaluar dispozitën specifike që rregullon pikërisht situatën e gabimeve aritmetike. Sipas parimit juridik, dispozita e posaçme që rregullojnë korrigjimin e gabimeve aritmetike duhet të ketë përparësi ndaj çdo interpretimi tjetër që çon në eliminim të ofertës. Përderisa është përcaktuar shprehimisht pragu prej 2%, asnjë autoritet, nuk mund ta injorojë atë prag dhe të aplikojë një standard më të ashpër sesa ai i paraparë në ligj.

Gjithashtu, duhet theksuar se gabimi i konstatuar nuk ka prodhuar asnjë efekt material në përmbajtjen e ofertës, nuk janë ndryshuar çmimet për njësi, nuk janë ndryshuar specifikimet teknike, nuk janë ndryshuar kushtet kontraktuale dhe nuk është krijuar asnjë avantazh konkurrues për ne si operator ekonomik. Për pasojë, eliminimi i ofertës tonë, nuk ka qenë masë proporcionale me natyrën e gabimit të konstatuar dhe përbën tejkalim ligjor të autoritetit kontraktues. Vendimi për eliminimin tonë, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 40.9 të Rregullores Nr.001/2022, nenin 59.3 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe me interpretimin zyrtar të KRPP-së mbi trajtimin e gabimeve aritmetike. Për rrjedhojë, vendimi i kontestuar është i paligjshëm, duhet të anulohet, ndërsa oferta jonë duhet të rikthehet në procesin e rivlerësimit, duke u zbatuar procedurën e korrigjimit të paraparë me ligj. Në vazhdim gjeni interpretimi ligjor nga KRPP, lidhur me gabimin aritmetik: 9. 22.11.2022 Gabimi aritmetikor ka ndodhë në ofertën financiare e jo në rubrikën (tabelën) për poentim të çmimeve. Cila vlerë mbizotëron, Vlera totale Financiare e ofertës për çmim njësi apo vlera totale e poentuar? Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor, si në vijim: Për gabimet aritmetikore, flet paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së, si dhe neni 40.9 i Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP). Paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së, përcakton: "3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti 7 kontraktues menjëherë do të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla". Paragrafi 3 i nenit 59 të LPP-së flet për gabimet tërësisht aritmetikore dhe si pas këtij paragrafi nëse gjatë vlerësimit të tenderëve AK zbulon mospërputhje në mes të çmimit për njësi dhe totalit, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe një përmirësim i tillë lejohet vetëm deri në 2% të vlerës totale të ofertës. Neni 40.9 i RRPP, përcakton: "40.9 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë

ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. a) Në rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësojë gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B49. në rast se OE në fjalë nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjalë do të refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. b) Në rast se shuma e korrigjuar është më shumë se +/- 2%, AK do të eliminojë OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B42.” Kurdo që AK përdorë poentimin, AK në përputhje me nenin 54.15 të RRPP, duhet të përcaktojë peshët në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull”. Meqenëse poentimi shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave dhe kontrata lidhet me çmime për njësi, kurdo që ka gabime aritmetikore (mospërputhje në mes të çmimit njësi dhe totalit të ofertës), gabimet e tilla korrigjohen në përputhje me paragrafin 3 të nenit 59 të LPP-së dhe në rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësojë gabimet e tilla dhe do të 9/4 informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B49 dhe më pas do të zbatojë formulën e poentimit në përqindje të përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Sipas nenit 59 të LPP-së, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues. Për të gjithë OE që pretendojnë se AK nuk i ka vlerësuar tenderët në përputhje me LPP dhe legjislacionin dytësor, LPP ka paraparë mjetet juridike për ti atakuar vendimet e AK-së (nenet 108/A dhe 109 të LPP së). Vërejtje: Në bazë të opinionit dhe ngjajres e cila ka ndondhur, sqaroj se gabimi është plotësisht aritmetik i cili ka rrjedhur pa qëllim, gabim i cili lidhet me totalin e ofertës financiare, i cili është i verifikueshëm, nga çmimet për njësi dhe sasitë e paraqitura në listën e çmimeve e cila ka ndikim më pak se 2 % dhe është nën pragun ligjor.

PRETENDIMI VI Shkelja e Nenit 59.4 të LPP-së se oferta jonë nuk përmban mangësi materiale që do të ndryshojnë përmbajtjen, qëllimin ose konkurrencën. Gabimi i identifikuar është i natyrës aritmetike dhe nuk prek çmimet për njësi, specifikimet teknike apo obligimet kontraktuale. Për pasojë, oferta duhej të konsiderohej e përgjegjshme. Autoriteti kontraktues nuk ka bërë dallimin ndërmjet një mangësie materiale, e cila prek substancën e ofertës, dhe një gabimi aritmetik, i cili nuk ndryshon përmbajtjen e saj. Ky dallim është thelbësor, sepse qëllimi i nenit 59.4 nuk është të ndëshkojë operatorët ekonomikë për çdo pasaktësi në numra, por të sigurojë që ofertat të mos kenë mangësi që cenojnë barazinë e trajtimit, konkurrencën ose ekzekutimin e kontratës.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka provuar me asnjë argument se gabimi i konstatuar ka prodhuar ndonjë ndryshim material në ofertën tonë.

PRETENDIMI VII Shkelja e Nenit 40.7 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik – Interpretim dhe zbatim i gabuar i konceptit të "devijimit substancial" Shkelja e Nenit 40.7 të Rregullores Sipas nenit 40.7, një devijim konsiderohet substancial vetëm kur ndryshon kushtet thelbësore të tenderit, ndikon në cilësinë ose ekzekutimin e kontratës, kufizon të drejtat e AK-së ose shtrembëron konkurrencën. Gabimi prej 1.10% nuk prodhon asnjërin nga këto pasoja. Për rrjedhojë, ky gabim nuk mund të konsiderohet devijim substancial dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për eliminim.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar gabimisht nenin 40.7 të Rregullores Nr.001/2022, duke e klasifikuar gabimin aritmetik të evidentuar në ofertën tonë si devijim substancial, pa provuar se janë përmbushur kushtet ligjore që kjo dispozitë kërkon për një përfundim të tillë. Neni 40.7 nuk e autorizon Autoritetin Kontraktues që çdo mospërputhje formale apo me numra ta trajtojë

si devijim substancial.

Përkundrazi, kjo dispozitë vendos kritere të qarta dhe objektive që duhet të plotësohen kumulativisht ose, së paku, të provohet ekzistimi i njërës prej pasojave materiale të përcaktuara në të. Në rastin konkret, asnjë nga këto elemente nuk është konfirmuar nga Autoriteti Kontraktues. Neni 40.7 i Rregullores Nr.001/2022 nuk duhet të interpretohet në mënyrë të izoluar, por në harmoni me: nenin 6 të LPP-së (ekonomiciteti dhe efikasiteti i prokurimit), nenin 7 të LPP-së (trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi), nenin 59 të LPP-së (vlerësimi i ofertave) dhe nenin 40.9 dhe 40.10 të Rregullores (gabimet aritmetike). Ky interpretim bie ndesh me qëllimin e Rregullores dhe zgjeron në mënyrë të paligjshme rastet e eliminimit të operatorëve ekonomikë. Përkundrazi, Autoriteti është mjaftuar me një konkluzion të përgjithshëm, pa shpjeguar se përse gabimi prej rreth 1.10% përbën devijim substancial.

PRETENDIMI VIII Shkelja e Nenit 40.8 të Rregullores nga autoriteti kontraktues, neni 40.8 i jep të drejtë AK-së të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Në rastin konkret, ne si operator ekonomik ju kemi njoftuar vetë për këtë gabimin aritmetik dhe kemi paraqitur sqarim me shkrim për vlerën e saktë të ofertës. Në këto rrethana, ju si AK është dashur dhe keni qenë të obliguar ta merrni parasysh sqarimin tonë dhe ti vlerësoni. Shkelja e Nenit 40.8 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik – Mosushtimi i drejtë i kompetencës për kërkimin dhe vlerësimin e sqarimeve të ofertës Autoriteti juaj Kontraktues ka zbatuar gabimisht nenin 40.8 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, duke mos e ushtruar në mënyrë të ligjshme dhe në përputhje me qëllimin e saj kompetencën për shqyrtimin dhe vlerësimin e sqarimeve lidhur me ofertën. Në rastin konkret, ne si operatori ekonomik, duke vepruar në mirëbesim dhe me transparencë të plotë, e kemi njoftuar vetë autoritetin kontraktues për ekzistimin e gabimit dhe kemi paraqitur një sqarim me shkrim, në të cilin ka shpjeguar natyrën e gabimit dhe ka evidentuar vlerën e saktë të ofertës.

Ky sqarim nuk kishte për qëllim ndryshimin e ofertës, përmirësimin konkurruese apo paraqitjen e një oferte të re, por vetëm shpjegimin e një pasaktësie aritmetike që nuk ndryshonte asnjë element thelbësor të ofertës. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk e kanë analizuar këtë sqarim dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim juridik se përse ai nuk është marrë në konsideratë.

PËRFUNDIM:

I. II. III. TË ANULOHEM NJOFTIMI PËR DHËNJË TË KONTRATËS

II. LËNDA TË KTHEHET NË RI-VLERËSIM

III. DHE NE SI OE PJESËMARRËS TË VLERËSOHEMI ME OFERTËN TONË TË DORËZUAR NË BAZË TË LPP-SË, SI OFERTË E PËRGJEGJSHME ME CMIMIM MË TË ULËT.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

24.06.2026, Prishtinë

Nga: Agjencia Qendrore e Prokurimit

Për: Grupi i Operatorëve Ekonomik: Rexhep Birinxhiku; Nita Macula B.I.

Titulli i kontratës: Furnizim me letër për kopje – Lot 2

Nr. i prokurimit	201/26300-26-2073-1-1-1
------------------	-------------------------

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Ju jeni eliminuar për arsye : Vlera totale e ofertës e paraqitur edhe tek përshkrimi i çmimit edhe tek Formulari i Tenderit është: (533,479.00€), si dhe nuk ka gabime në mes çmimeve njësi dhe çmimeve totale te secilit pozicion pra nuk ka gabime kur janë shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë (me këtë rast nuk përmbushet kriteri për gabim aritmetik sipas rregullores neni 40.10 pika a).) por shuma e totaleve e të gjitha artikujve nuk përputhet me vlerën totale të paraqitur të ofertës. Sipas nenit 23.10 - AK ka përpiluar Listën e Çmimeve ne Excel me formula te përgatitura ku ofertuesit kanë pasur për detyrë te plotësojnë vetëm “- Çmim për njësi” dhe çdo vlerë tjetër kalkulohet ne mënyrë automatike (kjo mund te vërtetohet ne çdo kohe duke shkarkuar Listën e Çmimeve për Lot 2 nga e-prokurimi), duke pasur parasysh mospërputhjen ne ofertën tuaj kjo tregon qe ju keni ndërhyrë ne Listën e Çmimeve dhe përgjegjësia për këtë gabim mbetet tek ju pasi qe nuk cilësohet si gabim aritmetik por qe edhe nuk është e mundeshe të jetë gabim teknik i paqëllimshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Rexhep Birinxhiku**

Aktiviteti i prokurimit me titull: **“Furnizim me leter per kopje” LOT 2** me nr. të prokurimit: **"201/26300-26-2073-1-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit, me procedurë të hapur, kontratë publike kornizë- furnizim, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar për LOT 2.

OE ankues është eliminuar me arsyetimin:

Ju jeni eliminuar për arsye: Vlera totale e ofertës e paraqitur dhe tek përshkrimi i çmimit edhe tek Formulari i Tenderit eshte: (533,479.00 Euor), si dhe nuk ka gabime në mes çmimeve njësi dhe çmimeve totale te secilit pozicion pra nuk ka gabime kur janë shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë (me këtë rast nuk përmushet kriteri për gabim aritmetik sipas rregullores neni 40.10 pika a.) por shuma e totaleve e të gjitha artikujve nuk përputhet me vlerën totale të paraqitur të ofertës. SIPAS NENIT 23.10- AK ka përpiluar Listën e çmimeve në Excel me formula të përgatitura ku ofertuesit kanë pasur për detyrë të plotësojnë vetëm “- çmim për njësi” dhe çdo vlerë tjetër kalkulohet në mënyrë automatike (kjo mund të vërtetohet në çdo kohë duke shkarkuar Listën e çmimeve për LOT 2 nga e-prokurimi), duke pasuer parasysh mospërputhjen në ofder tën tuaj kjo tregon që ju keni ndrëhyrë në Listën e çmimeve dhe përgjegjësia për këtë gabim mbetet tek ju pasi që nuk cilësohet si gabim aritmetik por që edhe nuk është e mundshme të jetë gabim teknik i paqëllimshëm.

OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat, gjegjësisht gjatë vlerësimit shkelë Ligjin për Prokurim Publik përkatësisht nenet: 6,7,60,59.4 dhe Rregulloren për prokurim publik nr: 001/2022 saktësisht nenet: 40.10; 40.7;40.8;

I njëjti në ankesë ka parashtruar pretendimet ankimore kundër arsyes së eliminimit, i cili konsideron se gabimi i totalit është gabim aritmetik i cili mund të përmirësohet, sipas të cilit AK ka vepruar në kundërshtim me LPP_në, në të njëjtën kohë duke e mbështetë konstatimin e tij në interpretimin e KRPP-së të datës 22.11.2022.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues kundër arsyes së eliminimit

Ekspertja shqyrtuese, pas analizimit të shkresave të lëndës, sqaron se Autoriteti Kontraktues në platformën E-Prokurim ka ngarkuar paramasën (përshkrimin e çmimeve për LOT 2). Kjo listë është e standardizuar, me kalkulime të gatshme, ku ofertuesit duhej vetëm të vendosnin çmimet për njësi, ndërsa sistemi (formulari Excel – Përshkrimi i çmimeve) bënte vetë kalkulimet.

Nga shqyrtimi i ofertës së Operatorit Ekonomik ankues, përkatësisht pretendimit të tij si arsye e eliminimit, rezulton se në listën e çmimeve për LOT 2, kalkulimet e çmimit për njësi dhe TVSH me sasinë janë korrekte. Ndryshimi shfaqet vetëm tek **totali me TVSH**. Nëse ky ndryshim do të konsiderohej si tendencioz apo lajthim nga OE ankues siq supozon AK, diferenca do të ishte pozitive. Në rastin konkret, OE ankues ka shënuar një vlerë më të lartë sesa ajo që realisht do të duhej të ishte. Pra, nëse do të kishte pasur tendencë për manipulim, OE do të kishte shënuar një vlerë më të ulët, në mënyrë që oferta të dilte më e favorshme, sipas kriterit çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Andaj duke qenë se furnizimi dhe fatura lidhet mbi çmimin për njësi, dhe gabimi aritmetik është nën **2% në total të ofertës**, ekspertja shqyrtuese vlerëson se AK, në rivlerësim rekomandohet të respektojë nenin 59.3 të Ligjit për Prokurimin Publik

Citat neni 59 par.3 LPP:

*3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, **çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor.** Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.*

Pretendimi i OE ankues gjendet i qëndrueshëm.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda LOT 2 të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Rexhep Birinxhiku**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me letër për kopje**” me numër të prokurimit: “**201/26300-26-2073-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Rexhep Birinxhiku**

Blerina Huruglica

